



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.01.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.01.2021, të parashtruar nga **Grupi i Operatorëve Ekonomik “Murseli Company” shpk & N.Sh.T. “Viktory Com” dhe Grupi i Operatorëve Ekonomik SH.”Drini” sh.p.k. & “Berisha Company”sh.p.k.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-Shpallje”Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane, me Nr. të Prok: 632-19-7809-2-1-1**, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Sh.“Drini Company”sh.p.k., e dt. 18.01.2021, të parashtruar nga **Grupi i Operatorëve Ekonomik “Murseli Company” shpk & N.Sh.T. “Viktory Com” dhe Grupi i Operatorëve Ekonomik SH.”Drini” sh.p.k. & “Berisha Company”sh.p.k.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-Shpallje”Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane, me Nr. të Prok: 632-19-7809-2-1-1**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 12.01.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
- 2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 12.01.2021;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**

## Ar sy e t i m

**Grupi i Operatorëve Ekonomik “Murseli Company” shpk & N.Sh.T. “Viktory Com” dhe Grupi i Operatorëve Ekonomik SH.”Drini” sh.p.k. & “Berisha Company”sh.p.k., me datë 18.01.2021, kanë parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-Shpallje”Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane, me Nr. të Prok: 632-19-7809-2-1-1.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.01.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

### **I- Përgjigje për Grupin e Operatorëve Ekonomik “Murseli Company” shpk & N.Sh.T. “Viktory Com”:**

- Ju si Operator Ekonomik listen e pajisjeve të prezantuara nuk është pranueshme pasi që ne të njëjten mungojnë të dhënat specifike mbi pajisjet/mjetet që do të përdoren nga OE. Në listën e pajisjeve të prezantuar është shënuar “*Ne pronësi dhe në marrëveshje me El Bau*”, mirëpo as në kontratën e qiramarrjes me “El Bau” nuk jepen të dhënat mbi specifikat e pajisjeve/mjeteve të cilat OE i ka kontraktuar, dhe si të tilla ato nuk mund të vërtetohen.

E njëjta e gjetur është vërtetuar/konstatuar edhe nga ana e OSHP-së përmes vendimit nr. 933-952/19 të dt. 10.02.2020

Në dosjen e tenderit janë paraqitur lista e kontratave dhe referencat relevante, dhe pas kërkesës për sqarim lidhur me tre referencat për punët e natyrës së ngjashme të lëshuara nga “*Grant Construction*” SH.P.K., nga “*Geo-Project*” SH.P.K, nga “*Art Konstruksion*” SH.P.K., komisioni ka konkluduar se OE ka dorëzuar të njëjtat dokumente si në dosjen e tenderit dhe se në bazë të dokumenteve dhe sqarimeve të dorëzuar nuk mund të vërtetohet nëse punët/kontratat janë përfunduar siç pretendohet me referencat e dorëzuara. Andaj, OE nuk plotëson kriterin e FDTs se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit, në një vlerë prej 350,000€, në rast të konsurciumit duhet të ketë të paktën 60% (210,000 EUR) e kontratave të natyrës së ngjashme;

-Grupit të Operatorëve Ekonomik D & T Group SH.P.K.; Florida Sh.p.k.; Horn & Co. Kosova SH.P.K, me dt.30.11.2020, sipas nenit 72 të LPP-së i është kërkuar që lidhur me referencën e lëshuar nga “Florida” SH.P.K. “Mirëmbajtja rutine dhe dimërore në aksin rrugor Bajram Curr – Fierze”, që të ofroj sqarime shtesë për situacionet e përfunduar se a e arrijnë vlerën e kërkuar prej 350,000€, në rast të konsurciumit duhet të ketë të paktën 60% (210,000 EUR) e kontratave të natyrës së ngjashme.Me dt. 01.12.2020, Grupit të Operatorëve Ekonomik D & T Group SH.P.K.; Florida Sh.p.k.; Horn & Co. Kosova SH.P.K,i ka sjellë dokumentet e kërkuara;

- Pretendimi juaj se Grupit të Operatorëve Ekonomik D & T Group SH.P.K.; Florida Sh.p.k.; Horn & Co. Kosova SH.P.K, i mungon qarkullimi në deklaratat tatimore nuk qëndron sepse i njëjti ka prezantuar deklaratën tatimore vjetore e cila e përmbush kërkesën e AK në FDT;

- **Lista e makinerisë dhe lista e Projekteve të prezantuara nga Grupit të Operatorëve Ekonomik D & T Group SH.P.K.; Florida Sh.p.k.; Horn & Co. Kosova SH.P.K,** është e njëjtë me listën e makinerisë dhe listën e projekteve në FDT;

-Pretendimi se asnjë makineri nuk është në pronësi të OE D&T, nuk qëndron sepse , për këtë arsye edhe krijohet konzorciumi – që anëtarët e konzorciumit të plotësojnë mangësitë e njëri tjetrit në mënyrë që të plotësohen kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT;

-Pretendimi se **Grupi i OE D&T Group,Florida,dhe Horn& Co Kosova nuk i kanë plotësuar Deklaratat nën betim ashtu siq duhet , nuk qëndron sepse deklaratat janë plotësuar ashtu siq është kërkuar në FDT**

-Pretendimi se **“tek Deklarata nën Betim për OE D&T të pika: Pozita: është cekur se Bledar Kusari drejtor kurse tek certifikatat e biznesit z.Bledar Kusari është vetëm një person i autorizuar kurse Drejtor është Kaltrina Batalli-Kusari dhe as nuk ka ndonjë autorizim si drejtor Ekzekutiv”** nuk qëndron sepse pozitën e personave në një kompani gjatë viteve mund të ndryshojnë;

## **II- Përgjigje për Grupin e Operatorëve Ekonomik SH.”Drini” sh.p.k. & “Berisha Company”sh.p.k.:**

- Autoriteti kontraktues konsideron se **OE D&T Group, me kontratën që ka me OE “Florida”** për projektin Mirëmbajtja rutine dhe dimërore aksii rrugor Bajram Curr-Fierze, U.Dushaj Sheshi i trageteve-Lekbibaj **i plotëson vlerën e 60% që duhet të ketë lideri;**

-**Pretendimi juaj I dytë është I pa bazuar sepse** askund nuk është shkruar se sa here ka të drejte AK të kërkojë sqarime rreth një kerkese për sqarim;

-Pretendimi juaj se lista e ofruar me rastin e dorëzimit të ofertave është tjetër ndërsa tani me sqarime shtesë është ofruar një listë tjetër –sqarojmë se Autoriteti kontraktues duke ju referuar Vendimit të OSHP ka kërkuar referenca shtesë;

-Për pretendimin tuaj se:

“ Ju e keni marr parasysh kontratën të cilën ne po e kontestojmë, dhe atë e keni pranuar si të vlefshme edhe pse nuk iu janë ofruar dëshmitë - transaksionet bankare të cilat i keni kërkuar ju.....”

Autoriteti kontraktues I është referuar Vendimit të OSHP, në të cilin Autoritetit kontraktues nuk I është rekomanduar që OE D&T Group t’I kërkojnë transaksione bankare;

-Pretendimi juaj se Autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë këtë grup të OE, përderisa në njoftimin mbi vendimin e datës 05.12.2019 e keni eliminuar me arsyetimin se nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme për punë të ngjashme, ju sqarojmë se edhe në këtë pikë Autoriteti kontraktues I është referuar Vendimit të OSHP;

-Pretendimi juaj se sqarime janë ofruar dëshmitë nga Gjykata themelore në Prishtinë Departamenti për çështje ekonomike për Florida Shpk-Dega në Kosovë, kurse konzorciumi është i përbërë nga Florida Shpk me adresë në Bajram Curr Lagja Dardania-Shqipëri, , ju sqarojmë se ne oferte eshte ofertuar me dokumente te RKS dhe per ketë arsye Autoriteti kontraktues ka kerkuar dokumentet per shpallje te fituesit të jenë të RKS-së;

-Pretendimi juaj se konzorciumit të rekomanduar për kontratë ju mungojnë deklaratat tatimore për 3 vitet e fundit siç është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë. Përkatësisht OE D&T GROUP i mungojnë deklaratat tatimore për vitet 2017, 2016, nuk është I bazuar sepse me deklaratën tatimore të vitit 2018, plotësohen kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT;

Pretendimi juaj se konzorciumit të rekomanduar për kontratë ju mungojnë pajisjet dhe makineritë nuk qëndron, sepse konzorciumi në fjalë I plotëson kërkesat e Autoritetit kontraktues për pajisje dhe makineri sipas FDT.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës

**Faton Gutaj**  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

